



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4019 Prot

Lezhë, më 29/04 /2022

VENDIM

Nr. 43, Datë 27 . 04 .2022

Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhet

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.1250, datë 11.03.2022 “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2022 në shumën 1,172,000 lekë, fond i cili është akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.05, Art.606 për shumën 1,172,000 lekë lekë, fond i cili do të përdoret për paga në shumën 1,004,284 lekë dhe sigurime shoqërore në shumën 167,716 lekë.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të kontigjencës në shumën 1,274,500 lekë, fond i cili do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhet, për këtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 1,274,500 lekë.

- Shtohet : Gr.00, Prog.10430, Kap.01, Art.600 për shumën 1,092,116 lekë dhe Art.601 për shumën 182,384 lekë, Këto shpenzime do të bëhen për 5 punonjësit e projektit “Tungjateta Jetë”.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

